



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1260 / Prot
5

Tiranë, më 06/12 /2013

URDHËR

Nr. 26 datë 06/12 /2013

Mbështetur në ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nr. 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit “**Laborator Natea**”.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 215 datë 10.10.2013, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit “**Laborator Natea**” me adresë, Rruga e Kavajës, mbi Qendrën Globe, Tiranë. Ky kontroll administrativ u fillua kryesisht nga Komisioneri.

Objekti i Kontrollit administrativ ishte:

- Plotësimi i detyrimit për njoftim (neni 21).
- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale/sensitive dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave (nenet 5-9 dhe 12-16).
- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale/sensitive dhe ruajtja e konfidencialitetit (neni 27 dhe 28).

Grupi i kontrollit administrativ:

- Intervistoi dhe mori deklarime nga përfaqësuesja e kontrolluesit.
- Inspektoi ambientet e punës të këtij kontrolluesi.

Gjatë kontrollit administrativ përfaqësuesja e kontrolluesit u tregua bashkëpunues dhe vendosi në dispozicion të grupit të kontrollit të gjitha materialet dhe dokumentat e kërkuara.

Kontrolluesi “**Laborator Natea**” e ushtron aktivitetin në fushën e kryerjes së testeve dhe analizave të ADN-së për përcaktimin e lidhjeve të gjakut ose familjare, atësisë dhe amësisë.

Gjatë këtij aktiviteti mbledh dhe përpunon të dhëna personale dhe sensitive për kategorinë klientë/pacientë.

Për kategorinë “klient/pacient” gjatë aktivitetit të tij kontrolluesi mbledh të dhëna personale të ndryshme, në varësi të dy llojeve të testeve, testeve jo ligjore dhe testeve ligjore. Gjatë testeve jo ligjore, të cilat mund të kryhen nga çdo person i interesuar, mblidhen të dhëna si: *emri, mbiemri, data e lindjes, qyteti, shteti, numri i telefonit, raca, mostrat e ADN-së (të marra në formë të ndryshme dhe të ruajtura në kitet e posaçme).*

Gjatë testeve ligjore, të cilat kryhen mbi bazën e një urdhëri të gjykatës, nëpërmjet një formulari të posaçëm (Formular i identifikimit të klientit), përveç të dhënave që mblidhen edhe në testet jo ligjore, mblidhen të dhëna të tilla si: *fotografia e klientit/pacientit dhe shenjat e gishtave.*

Të dhënat mblidhen nga mjekët, në mënyrë manuale, nëpërmjet plotësimit të formularëve por edhe elektronikisht, në rastet kur të dhënat administrohen nëpërmjet e-maileve që i dërgohen laboratorit DNA Diagnostic Center, në SHBA. Formularët së bashku me mostrat e ADN-së transferohen në SHBA, ku zhvillohen edhe testet. Pas kryerjes së testeve rezultatet (e vendosura në një formular) dërgohen në Shqipëri. Rezultatet arkivohen në dosje nga kontrolluesi.

Formularët që plotësohen nga klienti/pacienti janë në gjuhën angleze. Në këtë kuadër Komisioneri vlerëson se është e nevojshme që formularët për testet ligjore dhe jo ligjore të jenë në gjuhën shqipe në mënyrë që klienti/pacienti të jetë i informuar për përmbajtjen e tij dhe pëlqimi të jetë i plotë dhe i qartë.

Formularët plotësohen nga klienti/pacienti dhe në fund nënshkruhen prej tij. Kjo nënkupton edhe dhënien e pëlqimit.

Kontrolluesi mbledh edhe të dhëna nëpërmjet përdorimit të sistemit të video-survejimit të instaluar për të vëzhguar ambientet e brendshme të laboratorit por edhe hyrjen e jashtme e cila ndodhet në ambientet e përbashkëta të pallatit (në korridor).

Të dhënat personale të klientëve/pacientëve nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin për të cilat ato mblidhen dhe përpunohen. Qëllimi i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave personale për klientët/pacientët është vetëm kryerja e testeve dhe analizave të ADN-së për përcaktimin e lidhjeve të gjakut ose familjare.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson angazhimin e kontrolluesit “**Laborator Natea**” për të realizuar detyrimin për njoftim brenda afatit të përcaktuar në procesverbalin e kontrollit administrativ, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar.

Sa i përket respektimit të parimit të mjaftueshmërisë dhe proporcionalitetit në përpunimin e të dhënave personal të klientëve/pacientëve, Komisioneri vlerëson se përpunimi i të dhënave të tilla si *fotografia dhe shenjat e gishtave*, është në tejkalim të qëllimit i cili ka të bëjë thjesht kryerjen e testeve të ADN-së për përcaktimin e lidhjeve familjare. Këto të dhëna janë të tepërta dhe si të tilla nuk duhet të përpunohen.

Komisioneri vlerëson si të drejtë përpunimin e *racës*, e cila konsiderohet si e dhënë sensitive dhe gëzon një mbrojtje të veçantë, pasi, bazuar edhe në deklaratimet e përfaqësuesit të

kontrolluesit, kjo është një e dhënë e rëndësishme në veprimtarinë e laboratorit e cila ndihmon në përcaktimin e lidhjeve familjare bazuar në rezultatet e ADN-së dhe ndihmon në arritjen e qëllimit të kësaj veprimtarie.

Të dhënat personale dhe sensitive të klientëve mbahen në dosje fizike dhe në e-mail për një afat të pacaktuar. Komisioneri vlerëson se në këtë rast të dhënat mbahen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar. Në këtë kuadër, të dhënat personale dhe sensitive të klientëve të cilët e kanë marrë rezultatin e testeve dhe për të cilët ka përfunduar marrja e shërbimit nga laboratorit, duhet të fshihen. Këto të dhëna mund të mbahen vetëm nëse subjekti i të dhënave personale është i mirinformuar për qëllimin e mbajtjes, afatin e mbajtjes dhe jep pëlqimin në formë shkresore.

Në kuadër të zbatimit të nenit 6 dhe 7 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar, kontrolluesi merr pëlqimin e klientëve/pacientëve për përpunimin e të dhënave të tyre personale dhe sensitive nëpërmjet formularëve për testin jo ligjor dhe atë ligjor. Komisioneri vlerëson se pëlqimi i klientit/pacientit jepet në formë të qartë, pasi në çdo rast formulari pasi plotësohet, nënshkruhet prej tij. Gjithashtu në formularë duhet të parashikohet mundësia edhe e revokimit të pëlqimit, në çdo moment që klienti/pacienti e gjykon të arsyeshme, duke e bërë të paligjshëm përpunimin e mëtejshëm të të dhënave personale.

Komisioneri konstaton se kontrolluesi nuk ka praktikë për të informuar klientët për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tyre në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar.

Komisioneri konstaton se kontrolluesi nuk ka praktikë për të informuar klientët/pacientët për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tyre në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar, dhe pikës 3 të kreut II të Udhëzimit nr. 23 datë 20/11/2012 *“Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”*.

Komisioneri konstaton se kontrolluesi në faqen zyrtare në internet nuk ka të publikuar *“politikat e privatësisë”*, që janë një paketë rregullash të cilat kanë si qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen (të cilët mund të jenë edhe klientë/pacientë) mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave (klientëve/pacientëve) dhe detyrimet e kontrolluesit (laboratorit). Këto politika ndikojnë në sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.

Komisioneri konstaton se kontrolluesi nuk i kryen vetë testet e ADN-së por i dërgon formularët dhe mostrat e ADN-së në laboratorin DNA-Diagnostic Center i cili ndodhet në SHBA.

Komisioneri vlerëson se, në këtë rast kemi të bëjmë me transferim ndërkombëtar të të dhënave personale dhe sensitive drejt një vendi i cili konsiderohet me nivel jo të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale bazuar në Vendimin Nr. 3, datë 20.11.2012 të

Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

Transferimi kryhet mbi bazën e një marrëveshjeje (në gjuhën angleze) midis dy palëve. Nga analizimi i marrëveshjes, Komisioneri konstaton se në të nuk parashikohen të dhënat që do transferohen (pavarësisht se parashikohen në formularë), rregulla mbi mënyrën e transferimit të të dhënave personale dhe sensitive, masat e sigurisë gjatë transferimit, mënyrën e përpunimit të të dhënave dhe masat e sigurisë dhe konfidencialitetit gjatë përpunimit, afatet e përpunimit të të dhënave dhe mënyra e shkatërrimit të tyre pas përfundimit të marrëveshjes.

Gjithashtu konstatohet se nuk ka ndonjë format informimi të klientëve mbi transferimin e të dhënave të tyre, mënyrën e përpunimit, afatet e mbajtjes, masat e sigurisë dhe konfidencialitetit nga marrësi në SHBA, dhe parashikimet e detyrimeve sipas marrëveshjes.

Komisioneri vlerëson se transferimi ndërkombëtar kryhet në përputhje me kushtet ligjore të parashikuara në shkronjën b) të nenit 8 të ligjit dhe shkronjën a) të pikës 20 të Udhëzimit nr. 23, datë 20.11.2012 për “Përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”, pasi subjekti i të dhënave e jep pëlqimin për transferimin në formularët për testet ligjore dhe jo ligjore.

Komisioneri konstaton se laboratorit në SHBA është i regjistruar në programin Safe Harbour dhe në këtë kuadër vlerëson se marrësi siguron një nivel të mjaftueshëm mbrojtje të të dhënave personale dhe sensitive, bazuar edhe në Aneksin 1 të Vendimit Nr. 3, datë 20.11.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

Në kuadër të mbrojtjes së sigurisë së të dhënave personale të klientëve/pacientëve dhe ruajtjen e konfidencialitetit (neni 27, 28), Komisioneri konstaton se:

- Kontrolluesi i ka marrë të gjitha masat për sigurinë fizike të ambienteve dhe për sigurinë e dosjeve të klientëve duke i mbajtur në dollap me çelës;
- Kontrolluesi disponon një rregullore të brendshme por në të nuk parashikohen masa konkrete për sigurinë fizike dhe teknike të përpunimit të të dhënave personale dhe sensitive të klientëve/pacientëve.
- Personat që kanë akses në të dhënat personale dhe sensitive të klientëve, dhe që aksesojnë të dhënat e siguruar nga sistemi CCTV, nuk kanë nënshkruar një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sensitive.

Në kuadër të përpunimit ligjor të të dhënave personale të mbledhura nëpërmjet sistemit të video-survejjimit (referuar Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar), Komisioneri konstaton se:

- Kontrolluesi ka instaluar 2 kamera. Njëra është e vendosur në ambientet e brendshme të laboratorit dhe tjetra në hyrjen e jashtme e cila ndodhet në ambientet e përbashkëta të pallatit (në korridor). Aksesit në të dhëna është i kufizuar vetëm për administratoren e laboratorit. Kamerat janë fikse dhe me zmadhim të kufizuar.

- Kontrolluesi nuk ka një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit të video survejimit.
- Në ambientet e survejuara me kamera nuk ka tabela informuese lidhur me veprimin e sistemit të video survejimit.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative:

URDHËROJ

1. Në zbatim të shkronjës c) të nenit 5 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të dhënat e klientëve/pacientëve si *fotografia dhe shenjat e gishtave* nuk duhet të përpunohen pasi janë të tepërta dhe në tejkallim të qëllimit të përpunimit. Këto kategori të dhënash, që janë mbledhur deri tani, duhet të fshihen ose të shkatërrohen.
2. Në zbatim të shkronjës d) të nenit 5 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të dhënat personale të klientëve/pacientëve të cilët e kanë marrë rezultatin e testeve dhe për të cilët ka përfunduar marrja e shërbimit nga kontrolluesi “**Laborator Natea**”, të fshihen/shkatërrohen nga dosjet fizike dhe e-maili, pasi mbahen për një afat që e tejkalon qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar. Ato mund të përpunohen vetëm nëse klienti ka dhënë pëlqimin paraprak në formë shkresore.
3. Formularët për testet ligjore dhe jo ligjore duhet të jenë në gjuhën shqipe në mënyrë që klienti/pacienti të jetë i informuar për përmbajtjen e tij dhe pëlqimi të jetë i plotë dhe i qartë.
4. Në zbatim të shkronjës a) të pikës 2 të nenit 7 të ligjit, në formularë duhet të parashikohet mundësia e revokimit të pëlqimit, në çdo moment që klienti/pacienti e gjykon të arsyeshme, duke e bërë të paligjshëm përpunimin e mëtejshëm të të dhënave personale.
5. Në zbatim të nenit 18 të ligjit, kontrolluesi duhet të hartojë një praktikë për të informuar klientët/pacientët për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tyre.
6. Në faqen zyrtare në internet duhet të publikohen “politikat e privatësisë” (paketë rregullash) me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale/sensitive, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave (klientëve/pacientëve) dhe detyrimet e kontrolluesit (laboratorit) në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Politikat e privatësisë synojnë sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.

7. Të kryhet informimi i klientëve mbi procedurën e transferimit të të dhënave të tyre, mënyrën e përpunimit, afatet e mbajtjes, masat e sigurisë dhe konfidencialitetit nga marrësi në SHBA, dhe parashikimet e detyrimeve të palëve sipas marrëveshjes.
8. Në marrëveshjen që kontrolluesi “Laborator Natea” ka me laboratorin DNA-Diagnostic Center i cili ndodhet në SHBA duhet të parashikohen të dhënat që do transferohen (pavarësisht se parashikohen në formularë), rregullat mbi mënyrën e transferimit të të dhënave personale dhe sensitive, masat e sigurisë gjatë transferimit, mënyrën e përpunimit të të dhënave dhe masat e sigurisë dhe konfidencialitetit gjatë përpunimit, afatet e përpunimit të të dhënave dhe mënyra e shkatërrimit të tyre pas përfundimit të marrëveshjes.
9. Në zbatim të nenit 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar:
 - Personat që kanë akses në të dhënat personale dhe sensitive të klientëve dhe që aksesojnë të dhënat e siguruar nga sistemi CCTV, duhet të nënshkruajnë një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale.
 - Të hartohet një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale dhe sensitive të përpunuara për qëllime të ushtrimit të aktivitetit dhe të dhënat e mbledhura nga sistemi i video survejimit. Në të duhet të parashikohen masa konkrete sigurie, detyrimet e kontrolluesit dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
 - Në ambientet e survejuara me kamera të vendosen tabela informuese lidhur me veprimin e sistemit të video survejimit.
 - Për kamerën e vendosur në hyrjen e jashtme të laboratorit, e cila ndodhet në ambientet e përbashkëta të pallatit (në korridor), të merret pëlqimi në formë të shkruar i 75% të banorëve, në zbatim të legjislacionit për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”. Nëse pëlqimi nuk merret atëherë kamera duhet të hiqet.
10. Këto detyrimeve të rëndësishme që ju ngarkon ligji, të kryhen brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga dita e marrjes dijeni për këtë urdhër;
11. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
12. Në rast mospërmbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit: “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga

një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

